

Ramë MANAJ

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

SFIDAT AKTUALE PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË ARKIVORE NË KOSOVË

Abstrakt: *Arkivistika si veprimtari shoqërore e profesionale me rëndësi të veçantë për historinë, shkencën e kulturën si dhe për institucionet e qytetarët, vitet e fundit të paraluftës dhe ato të fillimit të pasluftës në Kosovë ka pësuar ngecje në zhvillim.*

Neglizhimi menaxherial deri në shkallë abuzimi në vitet e fundit të para luftës, mungesa e investimeve për kushte optimale materiale (tekniko-teknologjike e hapsinore) si dhe për profilizimin e kuadrit, bëhen faktorë negativë që gulfasin dhe stagnojnë ecuritë progresive në punën profesionale të arkivave. Rrjedhimisht gjendjen aktuale e karakterizojnë aspekte multidimensionale, të cilat sfidojnë ngritjen dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Përmbajtësisht këto sfida kanë të bëjnë me legjislacionin jociësor dhe të pamjaftueshëm, regjistraturat, punën e tyre dhe gjendjen e dokumentacionit – lëndës arkivore që e menaxhojnë, me mungesën e rregullativës nënligjore dhe sidomos (mos)zbatueshmërisë së saj, me mungesë të kushteve optimale për strehim, pra deponim të lëndës arkivore, për mbrojtje dhe ruajtje të saj në hapësirat e destinuara të tyre, me mungesë të aparaturave për klimatizim, për mbrojtje prej lagështisë, brejtësve, mykut, etj., me mungesën e kuadrit të kualifikuar e të profilizuar.

Një gjendje e këtillë, aspak më e mirë është edhe sot në institucionet publike arkivore, duke filluar nga niveli lokal e deri në atë qendror (Arkivat nëpër komuna e institucione tjera lokale, Arkivat ndërkomunale dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës).

Pasqyrimi i kësaj gjendjeje në “gro-plan”, disa ide e propozime referente për përballimin e këtyre sfidave dhe kapercimin e tyre janë objektivi dhe përpyekja që synohen të arrihen me shpjellimin tim të shkurtër brenda kësaj teme.

Fjalët çelës: *Veprimtaria arkivore, legjislacioni arkivor, gjendja në regjistratura, rregullativa nënligjore, zbatimi i saj, kushtet ambientale tekniko-teknologjike, depo arkivore, sfidat, masat për përmirësim të situatës.*

Veprimtaria arkivore në Kosovë, për një mori shkaqesh dhe nga më të ndryshmet, sikur e ka humbur hapin duke mbetur pas shumë veprimtarive tjera brenda vendit

dhe akoma më prapa, krahasuar me simotrat në rajon dhe më larg. Për pasojë kjo veprimtari sot ballafaqohet me sfida të shumta, pa përballimin e të cilave nuk mund të arrijë hapin, kurse këtë sfidë nuk do të mund ta kalojë pa përkrahje të duhur të shtetit.

Në një shtjellim, me makrodioptri, do të provoj të vë në pah sfidat kryesore, me qëllim që jo vetëm t'i bëhet e njohur dhe e qartë opinionit gjendja e deritanishme dhe aktuale, por edhe mundësitë e tejkalimit të suksesshëm të saj. Ky punim, pra, pretendon të paraqesë një analizë fizibiliteti, në shërbim të të ardhmes së arkivave në Kosovë.

Metodologjikisht, pranë ose pas çdo deskripsioni sado sipërfaqësor dhe konstatimi të gjendjes, kjo mëton të bëjë anamnezën, do të vendos idenë ose propozimin adekuat, natyrisht sipas meje, respektimi i të cilit do të ishte antibiotik i suksesshëm ose, së paku, një infuzion i domosdoshëm për momentumin.

Ligjet themelore që aktualisht janë të plotfuqishme dhe të zbatueshme në këtë fushë, me theks të veçantë Ligji për arkivat shtetërore Nr. 04/L-088, është tejet i varfër në përmbajtje kryesisht në kuptimin sasior. Si i tillë lë shumë zbrazëti juridike, ka mungesë norme. Ky ligj me gjithsejt 3 Kapituj dhe vetëm 20 nene, krahasuar me ligjin paraprak Nr. 2003/7 në praktikë del të jetë, sëpaku, përgjysmë më i dobët. Ligjit në fjalë i mungojnë provizione të tëra që do të duhej të rregullonin shumë çështje. Sa për ilustrim, në vijim përmend disa nga më kryesoret:

- ligj nuk definojnë organizimin strukturor të institucionit qendror të arkivave as të atyre lokale,
- Nuk parasheh mundësinë e funksionimit të një organi kolektiv profesional vendimmarrës ose sëpaku këshilldhënës,
- Nuk definojnë si duhet Rrjetin arkivor në vend dhe as koordinimin e duhur mes institucioneve arkivore të nivelit qendror me ato të nivelit lokal,
- Nuk përkufizon të drejtat e sigurimit të lëndës së vlerëshme arkivore me kompenzim material si dhe as mundësinë e export-importit të dokumentacionit arkivor për qëllime ekspozitash apo promovimesh të ndryshme kulturore, shkencore etj,
- Ligji nuk parasheh mbrojtje sanksionuese të lëndës arkivore nga shkelësit e dispozitave ligjore të kësaj lëmie, nga personat juridik apo fizik,
- Ligji nuk definojnë standarde ose kritere ligjore të numrit të të punësuarëve në proporcion me sasinë e lëndës arkivore,
- Ky ligj por as ndojë tjetër nga fusha e arsimit të lartë, nuk definojnë profilizimin e përgatitjes shkollore për kuadrin arkivor të kualifikuar, madje as ndonjë mundësi ligjore për aftësim, respektivisht çertifikim.

Më duket e domosdoshme në këtë moment të sqaroj se sot arkivistin tonë, sipas kualifikimit e bën i diplomuari në histori, gjuhësi, drejtësi, ekonomi ose drejtime tjera shoqërore, pa çertifikim profesional. Në Programin e Degës së Historisë, në margjina, zhvillohet një lëndë për arkivistikeë, e që është e pamjaftueshme.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, bashkë me Arkivat Ndërkomunale që veprojnë në gjashtë qendrat kryesoretë Kosovës, Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Gjilan, është institucioni qendror arkivor në vend. Ky institucion, në kuadër të veprimtarisë themelore ofron shërbime për qytetarët dhe institucionet. Mirëpo, këto shërbime ose nuk kompensohen fare ose fare simbolikisht, pra, nën koston e tyre. Paralel këtij realiteti, ASHAK në buxhetin e vet nuk ka fare mjete për investime kapitale, për të cilat gjithnjë ka shumë nevojë, sepse gjendja e objekteve, e teknologjisë dhe dixhitalizimi kërkojnë mjete financiare, të cilat i mungojnë, e MAP-i gjithë këto kohë nuk ka arritë pothuajja fare ose ka bërë fare, fare pak deri tani. Pra nëse nuk ka mbështetje të mjaftueshme buxhetore, kjo situatë do të mund të zbutet nëse me ligj do të lejohej shitja e shërbimeve të caktuara arkivore klientelës (kryesisht regjistraturave dhe institucioneve të tjera).

Propozim për zgjidhjet

Me urgjencë duhet proceduar dhe aprovuar ndryshimet dhe plotësimet e këtij Ligji për sa është cekur më lart dhe më shumë se kaq. Ky ligj është aprovuar në mars të vitit 2012 dhe menjëherë, që në vitin e parë të zbatimit të tij, jemi ballafaquar në praktikë me problemet e vështirësitë që ka prodhuar. Për pasojë, na është dashur që të kërkojmë që sa më shpejt të ishte e mundur ligji të amandamentohej dhe të plotësohej. Proceduralisht, këtë e kemi inicuar prej para afër katër vitesh. Aktualisht, koncept-dokumenti është në procedurë qeveritare, dhe ne presim me lutje e shpresë.

Parimisht dihet se sasia më e madhe lëndës arkivore me vlerë të përhershme të përdorimit, ndodhet jashtë arkivave, përkatësisht në regjistratura. Se cila është kjo sasi, cila është gjendja e saj, cilat janë konditat e ruajtjes dhe menaxhimit, sa prej kësaj sasive është maturuar për t'u dorëzuar në arkivat e shtetit, sipas ligjeve pozitive, janë disa nga pytjet e paanashkalueshme për të pasur pasqyrë reale të gjendjes. Por pa një inspektim profesional të të gjitha regjistraturave aktive e pasive në gjithë territorin e vendit, kjo nuk mund të arrihet. Aktualisht nuk kemi kapacitete të mjaftueshme njerëzore për një inspektim ose një sondazh të këtij

karakteri apo kësaj natyre. Ka munguar dhe mungon edhe mbështetja e duhur financiare për kësi ndërmarrjeje. Ndërkaq, kur kësaj i shtojmë faktin se ende nuk kemi statistika të plota për numrin e saktë të regjistraturave, atëherë, qartësisht puna bëhet akoma më e vështirë.

Nga ajo që dihet nga inspektimet e pamjaftueshme që janë bërë e vazhdojnë të bëhen, konkluzioni është: në shumicën e regjistraturave gjendja është larg standardevetë mbrojtjes e ruajtjes së lëndës arkivore, dhe për pasojë kjo lëndë në vazhdimësi i nënshtrohet procesit të dëmtimit permanent.

Nga ana tjetër, edhe po të ishte çdo gjë në rregull lidhur me lëndën arkivore nëpër regjistratura, janë faktorë tejet limitues përse i përket dorëzimit të saj për ruajtje të përhershme në Arkivat e shtetit. Hapsirat e pamjaftueshme, joadekuate dhe të papajisura të depove, si në objektin qendror këtu në Prishtinë, po ashtu edhe nëpër depot e Arkivave Ndërkomunale si dhe kapacitetet e pamjaftueshme njerëzore. Aktualisht, nëpër depot tona kemi gjithsejt 8,000 m gjatësi të lëndës arkivore apo 1,310 fonde gjithsejt.

Prej kësaj sasi, vetëm afër gjysma e saj i është nënshtruar procesit të përpunimit arkivor, kurse gjysma tjetër vazhdon të mbetet e papërpunuar, e parestauruar, e pasistemuar vazhdon të jetë e rrezikuar seriozisht për dëmtim të pjesërishtëm ose të plotë. Kjo gjendje është pasojë e kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore, përkundër faktit se norma e arkivistit tonë është më shumë se dyfish më e lartë, krahasuar me disa vende të rajonit kurse numri u punëtorëve deri trefish më i vogël.

Rasti i Maqedonisë

Kanë 13,000 metra gjatësi lëndë arkivore, por kanë staf prej 280 vetash, ose i Malit të Zi, me 5-600,000 banorë dhe një sasi të lëndës arkivore pak më shumë se ne, kanë staf prej 160 vetash. Ndërkaq, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, me gjashtë Arkiva Ndërkomunale në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren e Gjilan, me 8,000 metra gjatësi të lëndës arkivore në 2,320 fonde, kemi gjithsejt 90 punëtorë, prej të cilëve rreth 60% janë në shërbim të drejtpërdrejt të lëndës arkivore.

Propozimi i zgjidhjes

Gjendja e përshkruar mësipër është shtresuar për shumë vite, kurse edhe zgjidhja nuk mund të bëhet me “një lëvizje dore”, siç thuhet. Duhet investime jo të vogla,

por paralel me këtë duhet prioritizuar veprimet. Nevoja më urgjente mbesin lejimi buxhetor i shtimit, qoftë edhe gradual, të kapaciteteve njerëzore dhe përmirësimi e plotësimi i konditave materijale tekniko-teknologjike nëpër depo, sikundër edhe në hapsirat tjera.

Një sfidë, po kështu e karakterit ligjor, e cila dorën në zemër është më e hershme, është prania e një lloj “konflikti për kompetencë” në mes Arkivave Ndërkomunale, të cilat si “Expozitura” ose paralele të ndara vepronë në kuadër të ASHAK-së, me angazhim për të mbuluar fondkrijuesit aktivë në teritorin e komunave të regjionit përkatës. Na ana tjetër, Arkivat komunale (në interpretimin tim ato duhet të quheshin Arkiva të Komunave si fondkrijuese) mëtojnë të mbulojnë po ashtu gjithë fondkrijuesit e tyre. Rrjedhimisht del një kolizion i cili edhe praktikisht krijon problem. Dy subjekt, të dy instancave shtetërore (qendrore dhe lokale) mbulojnë të njëjtat hapsira dhe të njëjtit fondkrijues.

Propozim- zgjidhja

Me Ligjin e renovuar (të amandamentuar ose ligjin e ri) të definohen qartë kompetencat dhe të eliminohet dubioza: Nëse Arkivat Ndërkomunale duhet të vazhdojnë të mbulojnë regjistraturat nëpër komuna, atëherë Arkivat e Komunave do të mbulonin vetëm komunën dhe organet e saj si një fondkrijues. Në të kundërt, Arkiva Ndërkomunale do të duhet të pushonin së vepruari.

Ndonëse Ligji për Arkivat Shtetërore është vlerësuar i mangët, me dispozitat e përfundimtare premtonte që brenda gjashtë muajsh Qeveria do të nxjerrte akte nënligjore që do të plotësonin ligjin, deri sot, gadi gjashtë vite më pas, Qeveria ka nxjerr vetëm dy akte nënligjore, pra një Rregullore për shifrat unike të klasifikimit me afatet e ruajtjes së dokumenteve dhe një Udhëzim administrativ për menaxhimin e lëndës arkivore, gjë që është vërtetë fare pak. Megjithatë, këto dy akte nënligjore kanë plotësuar dukshëm vakumin e rregullativës ligjore në këtë fushë. Mirëpo, gjendja mbetet e brishtë në këtë kuptim tek regjistraturat (fondkrijuesit). Ata ende janë larg plotësimit, përkatësisht larg harmonizimit të akteve të tyre normative, të nevojshme, nënligjore, me ligjet në fuqi e kjo gjendje siguron kontinuitetin e menaxhimit të tejkaluar në kohë dhe metodologji të lëndës arkivore. Kështu, edhe tek regjistraturat, edhe për pasojë të mungesës së akteve cilësore normative, respektivisht i operativitetit të tyre, lënda dëmtohet dhe nuk arrin për mbrojtje të kualifikuar e ruajtje të përhershme në arkivat e shtetit.

Propozim-zgjidhja

Sipas rregullës “evito shkaqet për të eliminuar pasojat”, që gjendja ekzistuese të ndërpritet është e domosdoshme që me normë ligjore të sanksionohen përgjegjësitë edhe tek regjistraturat. Me fjalë tjera, përmes mbikqyrjes së shtuar inspektuese (aktualisht ka mungesë kapacitetesh njerëzore edhe në këtë pjesë) dhe sanksioneve përkatëse që synohet e duhet të parashikojë ligji i ri ose i amandamentuar edhe me shtim të mjeteve investive të përplotësohet dhe azhurnohet rregullativa juridike me zbatimin e saj. Kuadri joprofesional ka ndikim negativ edhe për sa i përket të mësipërmes.

Një tematikë më vete dhe krejtësisht specifike në gjithë kontekstin e sfidave, si në institucionin qendror shtetëror të arkivave të vendit, po ashtu edhe në ato ndërkomunale e lokale, dhe në gjithë regjistraturat paraqesin kushtet materialo-teknike e hapsirore ku vendoset për t’u ruajtur lënda arkivore. Në shumicën e të përmendurave, hapësirat mungojnë fare, janë të pamjaftueshme ose nuk janë të pajisura sa e si duhet. Pra, me pak përjashtime që mund të jenë sa gishtërinjtë e dorës (si shembuj pozitiv në këtë rast mund të veçohen Arkivi i Policisë së Kosovës, Arkivi i Komunës së Prishtinës, deri diku Arkivi i Komunës së Skënderajt dhe ndonjë tjetër), të gjitha, ose më saktë shumica dërmuese e tyre qëndrojnë keq në këtë plan, pra nuk i plotësojnë as minimalisht kushtet e domosdoshme që kërkohen me standarde dhe kriteret arkivore ndërkombëtare e kombëtare: nuk kanë raftë të duhura, nuk kanë aparatura për klimatizim, aparatura për mbrojtje nga lagështia, e çka është akoma më paradoksale, nuk kanë as aparatura speciale për mbrojtje nga zjarri i lëndës nepër depo. Për më keq, nuk ka mirëkuptim as vlerësim të gjendjes, nuk ka, sëpaku deri tani, as gadishmëri për të filluar një trajtim të përafërt meritore ndaj lëndës arkivore kudo që ajo prodhohet, menaxhohet, ruhet e mbrohet. Kështu, e them me shumë keqardhje, arkivat e Kosovës me gjendjen e tyre të trashëguar dhe aktuale ndodhen jo në shekullin 12, por në atë të 20-tin. Për këtë situatë, më së paku mund të jenë fajtorë arkivistët.

Përballë këtij realiteti të dëmshëm e të pakëndshëm, kur edhe shpresat për ndryshime e përmirsim na kishin rënë në agoni, Ministria jonë e Kulturës, në kuadër të së cilës jemi kthyer që nga fillimi i vitit 2017, jo vetëm që ka ringjalluar shpresat për ditë më të mira të arkivave dhe arkivistikës në Kosovë, por me përkrahjet e deritashme (natyrisht ende larg nevojave) po dëshmon praktikisht interesim dhe gadishmëri premtuese.

Rrjedhimisht, nëse duhet dhe duam që arkivat tona të jenë si ato në rajonin

tonë dhe përafërsisht si në botë, nëse duhet dhe duam që të kemi dhe të ruajmë historinë, pra thesarin e paçmuar që quhet lëndë arkivore, për gjeneratat që vijnë (kjo padyshim është edhe detyrë e kësaj gjenerate edhe e institucioneve shtetërore), atëherë nuk duhet injoruar këtë:

Propozim-zgjidhje

Kthimin e trajtimit meritore të domosdoshëm institucional-shtetëror ndaj arkivave dhe lëndës arkivore. Investim në përmirsimin gradual dhe të vazhdueshëm në kushteve për lëndën arkivore për të valorizuar rëndësinë e saj shtetërore, shoqërore, historike, shkencore e kulturore.